DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
MUNICIPALITY EDUCATION DIRECTORATE
OPSTINSKA UPRAVA PROSFETE
Nr. 287/24 Data. 14-03-2024
VUSHTRRI

**Republika e Kosovës - Komuna e Vushtrrisë**

**Republika Kosova- Opstina Vucitrn**

**Republic of Kosovo- Municipality Vushtrri**

**Drejtoria Komunale e Arsimit**

---

PROCESVERBAL

Konsultimi publik për Draft-Planin Komunal të veprimit për Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e obliguar në Komunën e Vushtrrisë 2024-2026.

Datë: 04.03.2024

Ora: 11:00

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin: prindër, drejtorët e shkollave të komunës së Vushtrrisë, psikologet e shkollave, përfaqësuese e Njësitit për të drejtat e fëmijëve znj. Hyrie Uka dhe zyrtarja e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore znj. Remzije Zekolli, takimin e shpalli të hapur z. Enver Bajrami i cili edhe e prezantoi draft planin, i cili plan bazohet në pesë shtylla:

1. Braktisja
2. Braktisja e heshtur
3. Parandalimi
4. Mosregjistrimi
5. Rikthimi në procesin mësimor

Tek analiza e gjendjes pati diskutime rreth braktisjes dhe braktisjes së heshtur.

**Remzije Zekolli,** zyrtare e lartë për koordinimin e të Drejtave të Njeriut dhe zyrtare për Barazi Gjinore tha: të shkurtesat faqe 3, mendoj se duhet të jetë NJKDNJ- Njësiti Komunal për të Drejta të Njeriut;

Te hyrja, faqe 4, të plotësohet: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës; Rregullorja për Realizimin e të Drejtave Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda;

Te konteksti, faqe 6 duhet të jetë komuna ka themeluar, e jo formuar, sepse NJDKNJ, komuna nuk harton institucione, por themelon, ndërsa komuna harton Rregullore, Plane etj.

**Hyrie Uka,** zyrtare për të Drejtat e Fëmijëve: tha se në këtë plan të veprimit duhet të përfshihet edhe ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe të ceket roli i njësitit komunal dhe detyrat e tij në këtë Draft - Plan.

**Nasuf Tahiri**, drejtor nga SHFMU "28 Nëntori" Vërrnicë: flet për vështirësitë që po has ekipi për braktisje dhe parandalim në nivel shkolla kur bëhet fjalë për nxënës në rrezik të braktisjes dhe nxënës të evidentuar me mungesa të shumta.

**Halil Parduzi,** drejtor në SHMU 2 Vushtrri: tregon për praktikat që ekipi në nivel shkolle ka ndërmarrë për rikthimin e nxënësve në procesin mësimor.

**Ardian Jashari,** drejtor në SHFMU "Liria" Stroc; tha se është e nevojshme të mbahen trajnime për Ekipin kundër braktisjes në nivel shkolle sepse është esenciale të dihet qartë se si t'u qasen nxënësve në rrezik të braktisjes.

Po ashtu drejtori Ardian tha se Draft-Plani komunal i Veprimit duhet të jetë në harmoni të plotë me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve.

**Faruk Selimi**, drejtor i SHFMU "Martirët" Reznik: tha se e përshëndet punën që ka bërë Ekipi komunal për EPRMB dhe po ashtu punën e MASHT-it sepse çdo herë ka nevojë për risi dhe të ketë mundësi për futjen e të dhënave shtesë për nxënësit të cilët janë nxënës potencial të braktisin shkollën.

Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve.

Procesmbajtëse ,

Edona Shotani

Datë: 04-03-2024

Lista e pjesemarrësve për diskutim për Plani për braktisje

| Nr rend | Emri dhe mbiemri |
|---|---|
| 1 | FIDANE MAXHUNI |
| 2 | LEONORA KRASNIQI |
| 3 | Galip Amolin |
| 4 | Manushage Vila Raci |
| 5 | Sadije Bajgora-Klinaku |
| 6 | Arlinda Feka Bexheti |
| 7 | Fatos Gubetini |
| 8 | Besim Imeri |
| 9 | Hysnet Elshani |
| 10 | Miranda Hoxha |
| 11 | Hadije Zuçaku |
| 12 | Dauline Hegrova Saraçi |
| 13 | ARDIAN JASHARI |
| 14 | Mengjime Jashari |
| 15 | Njomza Lahu |
| 16 | Bearta Krasniqi Hajra |
| 17 | Valbona Dreja |
| 18 | Mirjeta Maxhuni |
| 19 | Lavdim Klinaku |
| 20 | Fajuk Selimi |
| 21 | Halil Panduri |
| 22 | Hasuf Tahiri |
| 23 | Ferid Ardiu |
| 24 | Luljeta Birdaku |
| 25 | Arben Uka |
| 26 | Ardita Imeri |
| 27 | Hyrie Uka Hoxha |
| 28 | Lemnije Zeholli |
| 29 | Edona Shotani |
| 30 | Enver Bajrami |
| 31 | Nazmije Osmani |
| 32 | Visar Sadriu |
| | |
| | |
| | |
| | |
| | |